

Përmbledhje

Sistemi financiar në vend vazhdoi të shënoj rritje edhe gjatë tremujorit të dytë (TM2) të vitit 2018. Analiza krahasimore tremujore tregon për zgjerim të aseteve të sistemit financiar, kryesisht si rezultat i rritjes së aseteve të sektorit bankar dhe atij pensional.

Sektori bankar u karakterizua me rritje të aktivitetit kreditues, performancë të mirë financiare si dhe nivel të kënaqshëm të indikatorëve që matin shëndetin e sektorit. Në TM2 2018, asetet e sektorit bankar u rritën për 18.7 milionë euro, kryesisht rezultat i rritjes së kreditimit. Rritja e gjithsej stokut të kredive, ndër tjera, i atribuohet rritjes së kredive të reja gjatë kësaj periudhe, veçanërisht kredive me karakter investues (ndërmarrje) dhe atyre për konsum (ekonomi familjare). Sektorët ekonomik që u kredituan më shumë në këtë periudhë bazuar në stokun e kredive ishin tregtia, ndërtimtaria dhe prodhimtaria.

Rritja e kreditimit vazhdon të financohet kryesisht nga depozitat e mbledhura brenda ekonomisë së vendit, të cilat në fund të TM2 2018 përfaqësuan 79.3 përqind të gjithsej detyrimeve të sektorit. Në TM2 2018, depozitat u rritën për 11.9 milionë euro, kryesisht si rezultat i zgjerimit të depozitave të ndërmarrjeve të mbajtura në sektorin bankar gjatë kësaj periudhe.

Në TM2 2018, normat e interesit në kredi kanë vazhduar trendin rënës, kurse ato në depozita kanë shënuar një rritje të lehtë vjetore. Norma e interesit në kredi në TM2 2018 qëndroi në nivel prej 6.7 përqind, kurse në depozita në 1.2 përqind.

Sektori bankar u karakterizua me performancë të kënaqshme financiare gjatë TM2 2018, duke realizuar fitim neto prej 20.9 milionë euro, por që është më i ulët krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Rënia e lehtë e profitit të realizuar, ishte kryesisht pasojë e rritjes së shpenzimeve, përderisa edhe të hyrat kishin rënie të lehtë në krahasim me TM2 2017.

Sektori bankar shënoi përmirësim të indikatorëve kyç të shëndetit financiar. Në TM2 2018, sektori bankar u karakterizua me rënie të nivelit të kredive joperformuese (2.8 përqind) dhe përmirësim të mbulueshmërisë së tyre me provizione (155.6 përqind). Në të njëjtën periudhë, Treguesi i Mjaftueshmërisë së Kapitalit qëndroi në nivel prej 17.4 përqind, përderisa sektori gëzoi edhe nivel të kënaqshëm të likuiditetit prej 33.2 përqind.

Në TM2 2018, sektori pensional shënoi rritje të aseteve, e cila u reflektua edhe në rritjen e peshës së sektorit në asetet e sistemit financiar krahas periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Në tremujorin e dytë, ky sektor u karakterizua me ecuri pozitive të kontributeve të reja, e po ashtu performancë pozitive sa i përket kthimit bruto nga investimet.

Sektori i sigurimeve mbylli këtë tremujor me rezultat pozitiv financiar, megjithëse në vlerë më të ulët krahas tremujorit të njëjtë në vitin paraprak. Më saktësisht, faktorët që ndikuan në dinamikat e sektorit të sigurimeve ishin rritja në të hyrat neto nga primet dhe menaxhimi efikas i shpenzimeve të sektorit, ndërsa faktorët të cilët kontribuan negativisht ishte rritja e theksuar e dëmeve të ndodhura gjatë TM2 2018.

Sektori mikrofinanciar ka vazhduar të rrisë aktivitetin, ku edhe tremujori i dytë u karakterizua me rritje të theksuar të aseteve si rezultat i rritjes së stokut të kredive të këtij sektori. Njëkohësisht, dinamikat në këtë sektor dhe rritja e të hyrave rezultuan në rritje të profitit gjatë këtij tremujori.

Tregu i letrave me vlerë të Qeverisë së Kosovës gjatë këtij tremujori u karakterizua me rënie të vlerës së emetuar dhe rritje të afatit të maturimit, por kërkesë më të lartë për të investuar në letrat me vlerë. Maturiteti më i gjatë i ofruar mund të ketë ndikuar në rritjen e normës së përgjithshme të interesit në TM2 2018.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE-----i

Sistemi Financiar -----	04
Sektori Bankar -----	04
Sektori Pensional-----	12
Sektori i Sigurimeve -----	14
Sektori Mikrofinanciar -----	15
Tregu i Letrave me Vlerë -----	18

GRAFIKËT DHE TABELAT

Figura 1. Vlera e asetëve të sistemit financiar të Kosovës -----	04
Figura 2. Asetet e sektorëve përbërës të sistemit financiar -----	04
Figura 3. Ndryshimi vjetor në strukturën e asetëve të sektorit bankar -----	05
Figura 4. Ndryshimi vjetor në vlerën e gjithsej kredive dhe kategorive kryesore -----	05
Figura 5. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike -----	06
Figura 6. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake -----	07
Figura 7. Vlera e gjithsej depozitave dhe kategorive kryesore në TM2 -----	07
Figura 8. Struktura e bilancit të depozitave në TM2 -----	07
Figura 9. Norma e interesit në kredi dhe depozita -----	08
Figura 10. Norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare -----	08
Figura 11. Norma e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik -----	09
Figura 12. Norma e interesit në depozita -----	09
Figura 13. Norma e interesit në depozitat -----	09
Figura 14. Norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve -----	10
Figura 15. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare -----	10
Figura 16. Profiti neto i sektorit bankar -----	10
Figura 17. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar -----	10
Figura 18. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar -----	11
Figura 19. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve -----	12
Figura 20. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës -----	12
Figura 21. Asetet e sektorit pensional -----	12
Figura 22. Struktura e asetëve të FKPK-së -----	13
Figura 23. Struktura e asetëve të FSKP-së -----	13
Figura 24. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së -----	13

Figura 25. Asetet e sektorit të sigurimeve -----	14
Figura 26. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara -----	14
Figura 27. Asetet e sektorit mikrofinanciar -----	15
Figura 28. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve -----	16
Figura 29. Vlera e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik-----	16
Figura 30. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar -----	17
Figura 31. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar-----	17
Figura 32. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik-----	17
Figura 33. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar -----	18
Figura 34. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar-----	18
Figura 35. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore -----	18
Figura 36. Shuma e borxhit të emetuar -----	19
Figura 37. Shuma e kërkuar dhe e emetuar -----	19
Figura 38. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë -----	19
Tabela 1. Numri dhe shuma e letrave me vlerë të arkëtuara nga Qeveria e Kosovës -----	19
Tabela 2. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	21


SHKURTESAT:

APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
CHF	Franku Zvicërran
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
GBP	Poundi Britanik
IHD	Investimet Huaja Direkte
KJP	Kreditë Jopërfomuese
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
USD	Dollari Amerikan
WEO	World Economic Outlook

Sistemi Financiar

Sistemi financiar shënoi rritje në të gjithë sektorët përbërës të tij. Kontribut më të lartë në rritjen e aseteve të sistemit financiar kishin veçanërisht asetet e sektorit bankar dhe atij pensional, përderisa sektori i sigurimeve dhe ai mikrofinanciar kishin kontribut pozitiv por më të vogël në zgjerimin e aseteve të sistemit.

Figura 1. Vlera e aseteve të sistemit financiar të Kosovës




Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur
Burimi: BQK (2018)

Të gjithë sektorët përbërës të sistemit financiar rritën asetet e tyre në periudhën raportuese duke arritur vlerë prej 6.0 miliardë euro në fund të TM2 2018 dhe rritje vjetore prej 7.8 përqind (figura 1). Zhvillimet pozitive të sistemit financiar kontribuan në shtrirje më të madhe të qasjes së publikut në shërbime financiare.

Ndërkaq, në baza tremujore, asetet e sistemit financiar u rritën për 96.3 milionë euro në TM2 2018 kundrejt tremujorit të njëjtë të vitit paraprak, kryesisht si pasojë e rritjes së aseteve të sektorit bankar si dhe sektorit pensional (figura 2).

Figura 2. Asetet e sektorëve përbërës të sistemit financiar



Zgjerimi i aktivitetit të sektorit bankar dhe atij mikrofinanciar kryesisht u mbështet nga gatishmëria e tyre për zgjerimin e aktivitetit kreditues. Ndërsa, zgjerimi i aseteve të sektorit pensional u mbështet nga arkëtimet e reja dhe zhvillimet pozitive në tregjet e huaja financiare e që rezultuan në kthim pozitiv nga investimi i aseteve të sektorit në tregjet financiare përkatëse. Sektori i sigurimeve, po ashtu u karakterizua me rritje të primeve bruto të shkruara si dhe rritjes së të hyrave dhe menaxhimit efikas të shpenzimeve përkundër rritjes së dëmeve të ndodhura.


Sektori Bankar

Sektori bankar u karakterizua me rritje të përshpejtuar të aseteve dhe performancë të mirë financiare, si rezultat i përshpejtimit të aktivitetit kreditues kundrejt periudhës së njëjtë të vitit paraprak. Bankat po ashtu pasqyruan nivel të kënaqshëm të indikatorëve që matin shëndetin e sektorit.

Asetet

Në TM2 2018, asetet e sektorit bankar u zgjeruan për 18.7 milionë euro dhe arritën vlerën prej 3.89 miliardë euro në fund të periudhës. Rritja e aseteve të sektorit bankar kryesisht i atribuohet rritjes së kreditimit i mbështetur nga oferta e lehtësuar për kredi e aplikuar nga bankat. Në krahasim me tremujorin paraprak pothuajse të gjitha kategoritë e aseteve shënuan rënie, zhvillim që sugjeron orientimin e aseteve në kreditim (figura 3).

Figura 3. Ndryshimi vjetor në strukturën e aseteve të sektorit bankar



Burimi: BQK (2018)


Për dallim nga tremujori i njëjtë i vitit paraprak, paraja e gatshme dhe bilanci me BQK-në u zvogëluan për 37.1 milionë euro në TM2 2018, dhe zbritën në vlerë prej 426.9 milionë euro në fund të periudhës së cekur. Zvogëlimi i kësaj kategorie kryesisht reflekton nivelin e parasë së gatshme të mbajtur në trezor të bankave dhe në BQK, që u zvogëlua për 13.9 milionë euro respektivisht 23.2 milionë euro kundrejt TM2 2017. Ky zhvillim pasqyron zhvendosjen e aseteve të sektorit bankar në asete më profitabile si kreditimi, që këtë tremujor përshpejtoi rritjen.

Në TM2 2018, stoku i letrave me vlerë të sektorit bankar u zvogëlua për 25.9 milionë euro dhe zbriti në vlerë prej 450.8 milionë euro në fund të periudhës raportuese. Gjithsesi, krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit 2018, stoku i letrave me vlerë u karakterizua me rritje vjetore prej 5.9 milionë euro. Normat e ulëta të kthimit në letra me vlerë mund të kenë rezultuar në zhvendosjen e fokusit të bankave nga investimeve në tregun e letrave me vlerë drejt aktivitetit kreditues, si instrument me kthim më të lartë.

Kreditë

Kreditë e lëshuara nga sektori bankar shënuan rritje të përshpejtuar në TM2 2018. Sektori bankar kreditoi ekonominë vendore në vlerë prej 127.0 milionë euro gjatë TM2 2018, duke arritur vlerën në 2.66 miliardë euro në fund të periudhës së cekur (figura 4).

Figura 4. Ndryshimi vjetor në vlerën e gjithsej kredive dhe kategorive kryesore




Burimi: BQK (2018)

Ndikim në rritjen e kredive aktive kishin kreditë e reja të lëshuara si për ndërmarrjet (të cilat shënuan vlerën prej 229.1 milionë euro në TM2 2018) ashtu edhe për ekonomitë familjare (të cilat shënuan vlerën prej 165.0 milionë euro). Ecuria në stokun e gjithsej kredive aktive dhe atyre të reja, ndër tjerash, u

ndikuan nga oferta lehtësuese e aplikuar nga bankat përmes përmirësimit të kushteve të kreditimit për të dy kategoritë ekonomike.

Në krahasim me TM1 2017, gjithsej stoku i kredive ndaj ndërmarrjeve u rritën për 32.0 milionë euro dhe arritën vlerën prej 1.70 miliardë euro në fund të periudhës (figura 4). Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, sektori i tregtisë dhe ai i ndërtimtarisë shënuan rritjen më të lartë, pasuar nga sektori i prodhimtarisë (figura 5).

Figura 5. Struktura e kredive sipas veprimtarisë ekonomike




Bilanci i kredive për sektorin e tregtisë, të cilat dominojnë strukturën e gjithsej kredive të ndërmarrjeve, ishte 53.7 milionë euro në TM2 2018 dhe stoku i tyre arriti vlerën prej 855.7 milionë euro në fund të periudhës së cekur. Në anën tjetër, kreditimi ndaj sektorit të ndërtimtarisë gjatë tremujorit të dytë ishte 14.7 milionë euro, duke arritur vlerën e stokut prej 147.7 milionë euro. Kreditë ndaj sektorit të prodhimtarisë vazhduan të karakterizohen me rritje edhe në TM2 2018 (9.3 milionë euro), ku vlera e stokut arriti në 202.0 milionë euro.

Kreditë ndaj ekonomive familjare në TM2 2018 ishin 41.2 milionë euro dhe arritën vlerën e stokut të kredive prej 958.4 milionë euro. Kjo rritje ndër tjerash reflekton ecurinë në kreditë e reja të lëshuara nga bankat gjatë kësaj periudhe. Më konkretisht, gjatë kësaj periudhe, vlera e kredive të reja të destinuara për konsum arriti vlerën në 127.1 milionë euro, apo 18.3 milionë euro më shumë se sa vlera në TM2 2017. Kurse, kreditë e reja hipotekare të lëshuara nga bankat arritën vlerën prej 26.9 milionë euro, apo 1.0 milionë euro më shumë se sa vlera në TM2 2017.

Detyrimet dhe Burimet Vetanake

Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake të sektorit bankar dominohet nga depozitat, të cilat përbëjnë 79.3 përqind të gjithsej detyrimeve. Në krahasim me tremujorin e kaluar ku depozitat kishin rënie, TM2 2018 ka një bilanc prej 11.9 milionë euro më shumë, dhe rritje vjetore prej 35.7 milionë euro në krahasim me TM2 2017.

Figura 6. Struktura e detyrimeve dhe burimeve vetanake




Kategoria e dytë më e rëndësishme, ajo e burimeve vetanake, kryesisht si rezultat i rritjes së fitimit të realizuar, u karakterizua me rënie prej 3.2 milionë

euro në krahasim me tremujorin e kaluar. Kategoritë tjera nuk pësuan ndryshime të dukshme në kuadër të strukturës së gjithsej detyrimeve dhe burimeve vetanake në TM2 2018 (figura 6).

Depozitat

Depozitat në sektorin bankar të Kosovës u rritën për 11.9 milionë euro në TM2 2018 në baza tremujore, dhe shënuan vlerën prej 3.09 miliardë euro. Dinamikat që karakterizuan depozitat e sektorit bankar në TM2 2018 kryesisht i atribuohen zhvillimeve në kuadër të depozitave si për ndërmarrjet ashtu edhe për ekonomitë familjare. Depozitat e ndërmarrjeve u rritën për 9.7 milionë euro kundrejt tremujorit të paraprak dhe arritën vlerën prej 698.7 milionë euro në fund të periudhës së cekur.


Figura 7. Vlera e gjithsej depozitave dhe kategorive kryesore në TM2



Në anën tjetër, depozitat për ekonomitë familjare u rritën për 8.8 milionë euro kundrejt tremujorit paraprak dhe arritën vlerën prej 2.23 miliardë euro në fund të periudhës (figura 7).

Rritja e depozitave të ekonomive familjare në këtë tremujor mund t'i atribuohet deri në një masë rritjes së të hyrave në ekonomi gjatë këtij tremujori si rrjedhojë e rritjes së pagës neto mesatare¹ dhe rritjes së remitencave gjatë këtij tremujori. Rritja e lehtë e normave të interesit në depozita mund të ketë kontribuar po ashtu në këtë rritje. Në anën tjetër, rritja e normës së interesit në depozitat e ndërmarrjeve, mund të ketë ndikuar deri në një masë në rritjen e depozitave të ndërmarrjeve gjatë këtij tremujori (figura 7).

Figura 8. Struktura e bilancit të depozitave në TM2



Sipas kategorive të depozitave, depozitat e transferueshme u rritën për 10.0 milionë euro në TM2 2018 në baza tremujore, dhe shënuan vlerën prej 1.84 miliardë euro në fund të periudhës së cekur. Gjithashtu, depozitat e afatizuara shënuan rritje për 10.5 milionë euro në këtë tremujor dhe arritën vlerën prej 773.9 milionë euro në fund të periudhës. Në anën tjetër, depozitat e kursimit në baza tremujore u zvogëluan për 9.7 milionë euro, dhe zbritën në vlerë prej 471.6 milionë euro në fund të periudhës së cekur (figura 8).


¹ Sipas Buletinit Tremujor TM2 2018, Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) (Korrik 2018)

Normat e interesit në depozitat e kursimit mund të ketë ndikuar në zvogëlimin e kësaj kategorie të depozitave.

Normat e Interesit²

Në TM2 2018, normat e interesit në kredi kanë vazhduar trendin rënës, kurse ato në depozita kanë shënuar një rritje të lehtë vjetore. Dallimi në mes të normës të interesit në kredi dhe asaj në depozita u zvogëluar në 5.4 pikë përqindje (5.7 pikë përqindje në TM2 2017).

Figura 9. Norma e interesit në kredi dhe depozita



Burimi: BQK (2018)


Norma e interesit në kredi në TM2 2018 u zvogëluar në 6.7 përqind përderisa norma e interesit në depozita shënoi rritje të lehtë në 1.2 përqind (figura 9).

Normat e interesit në kredi

Norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve zbriti në 6.3 përqind, nga 6.5 përqind sa ishte në TM2 2017 (figura 10).

Të gjitha kategoritë e normave të interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve në TM2 2018 shënuan rënie vjetore. Rënia më e madhe (0.3 pikë përqindje) u shënuar tek kreditë për qëllime jo-investuese, duke zbritur në 6.2 përqind. Në periudhën raportuese, normat e interesit në kreditë për qëllime investuese bartën normë të interesit prej 5.9 përqind. Kategoritë tjera të normave të interesit të aplikuara për ndërmarrjet siç janë ato me kushte favorizuese gjithashtu shënuan rritje gjatë kësaj periudhe, megjithatë vazhdon të bart normë mjaftë të ulët të interesit (3.4 përqind në TM2 2018), duke marrë parasysh që janë të mbuluara me para të gatshme dhe asete tjera likuide.

Figura 10. Norma e interesit në kreditë ndaj ndërmarrjeve dhe ekonomive familjare




Burimi: BQK (2018)

Normat e interesit në kreditë ndaj të gjithë sektorëve ekonomik vazhduan të shënojnë rënie, por me ritëm më të ngadalësuar krahasuar me vitin 2014 dhe 2015. Në TM2 2018, normën më të ulët të interesit në kredi shënoi sektori i industrisë dhe ai i shërbimeve, përderisa normën më të lartë të interesit e bartë sektori i bujqësisë (figura 11).

² Kalkulimi i normave të interesit: mesatarja tremujore e normave të interesit në kredi, gjegjësisht në depozita. Në tekst ju referohemi si 'normë e interesit'.


Figura 11. Norma e interesit në kredi, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2018)

Normat e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare ndoqën trendin e përgjithshëm të normave të interesit të aplikuara nga bankat. Normat e interesit të aplikuara për kreditë hipotekare vazhdojnë të jenë më të favorshme, duke qenë se kreditë e destinuar për këtë kategori të ekonomive familjare janë të siguruar me patundshmëri.

Figura 12. Norma e interesit në kreditë ndaj ekonomive familjare, sipas qëllimit



Burimi: BQK (2018)


Në TM2 2018, norma e interesit e aplikuar për kreditë hipotekare qëndroi në 5.9 përqind, një rritje prej 0.1 pikë përqindje krahasuar me TM2 2017. Përderisa, normat e interesit të aplikuara për kreditë konsumuese janë dukshëm më të larta dhe qëndrojnë

mesatarisht në 7.4 përqind, megjithëse janë karakterizuar me rënie vjetore prej 0.1 pikë përqindje (figura 12).

Normat e interesit në depozita

Normat e interesit në depozita, pavarësisht rritjes së lehtë në vitin e fundit, vazhdojnë të jenë në nivele mjaftë të ulëta krahasuar me periudhat para vitit 2014 (figura 13).

Figura 13. Norma e interesit në depozita




Burimi: BQK (2018)

Normat e interesit në depozitat për ndërmarrjet vazhdojnë të jenë më të favorshme krahasuar me normat që ofrohen për ekonomitë familjare.

Në depozitat e ndërmarrjeve, norma e interesit qëndroi në nivel prej 1.7 përqind në TM2 2018, një rritje për 0.2 pikë përqindje krahasuar me tremujorin e dytë të vitit paraprak. Më konkretisht, rritje shënuan normat e interesit në depozitat e afatizuara (1.7 përqind në TM2 2018 nga 1.5 përqind në TM2 2017). Normat e interesit në depozitat e kursimit të ndërmarrjeve shënuan ngritje të lehtë kurse ato të transferueshme mbetën në nivele të ngjashme me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (figura 14).


Figura 14. Norma e interesit në depozitat e ndërmarrjeve, sipas kategorive



Burimi: BQK (2018)

Normat e interesit në depozitat e ekonomive familjare qëndruan në 1.1 përqind në TM2 2018 (figura 15). Norma e interesit në depozitat e transferueshme (0.001 përqind), të kursimit (0.3 përqind) dhe ato të afatizuara (1.1 përqind) në TM2 2018 janë të përafërta me normat e aplikuara në TM2 2017, dhe pothuajse të pandryshueshme nga tre vitet e fundit.

Figura 15. Norma e interesit në depozitat e ekonomive familjare, sipas kategorive




Burimi: BQK (2018)

Performanca e sektorit bankar

Vlera e profitit të realizuar në TM2 2018 arriti në 20.9 milionë euro, e që është për 3.3 milionë euro më e ulët krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit

paraprak (figura 16). Në baza vjetore, rënia e lehtë e profitit të realizuar në TM2 2018 i atribuohet kryesisht rënies së të hyrave nga jo-interesi.


Figura 16. Profiti neto i sektorit bankar, në milionë euro



Burimi: BQK (2018)

Të hyrat e sektorit bankar në TM2 2018 u karakterizuan me rritje të theksuar, kryesisht si rezultat i rritjes së të hyrave nga interesi. Gjithashtu, edhe të hyrat nga jo-interesi u karakterizuan me rritje tremujore. Megjithatë, krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak, vlera e gjithsej të hyrave u zvogëlua për 2.0 milionë euro dhe zbriti në 59.5 milionë euro (figura 17).

Figura 17. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit bankar



Burimi: BQK (2018)


Në anën tjetër, vlera e gjithsej shpenzimeve të sektorit bankar në TM2 2018 arriti në 37.5 milionë euro, një rritje prej 0.2 milionë euro kundrejt tremujorit të njëjtë të vitit paraprak (figura 17).

Rritja e shpenzimeve të sektorit bankar kryesisht i atribuohet rritjes së shpenzimeve të jo-interesit që u rrit për 2.3 milionë euro në baza vjetore. Në kuadër të shpenzimeve të jo-interesit, ndikimin më të lartë në rritje e kishin nënkategoria e provizioneve të ndara për humbjet e mundshme në kredi. Kjo nënkategori u rrit për 2.2 milionë euro krahasuar me TM2 2017, duke arritur në 6.8 milionë euro. Në kuadër të shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative, në krahasim me TM2 2017 të gjitha nënkategoritë përbërëse (të personelit, të përgjithshme, dhe të tjera) shënuan rënie. Po ashtu, shpenzimet e interesit në baza vjetore kishin një rënie të lehtë periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kryesisht si rezultat i ndryshimit në normat e interesit në huamarrjet nga ana e bankave si dhe rënia e normave të interesit të produkteve tjera financiare.

krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, duke qëndruar në 63.1 përqind. Kjo erdhi si rezultat i rënies së përgjithshme të hyrave në një periudhë të rritjes së shpenzimeve, edhe pse marginale, krahasuar me TM2 2017(figura 17).

Performanca financiare e sektorit bankar në këtë tremujor u reflektua edhe në dy indikatorët e profitabilitetit, kthimin në mesataren e aseteve (KMA) edhe kthimin në mesataren e kapitalit (KMK). KMA u zvogëlua për 0.4 pikë përqindje në 2.4 përqind, përderisa KMK u zvogëlua për 4.1 pikë përqindje në 18.7 përqind në TM2 2018 (figura 18). Rënia e indikatorëve në fjalë pasqyron fitimin më të ulët të këtij tremujori me atë të tremujorit të njëjtë të vitit paraprak. Për më tepër, për shkak të variablës së ‘fitimit para tatimit’ si pjesë e kalkulimit të indikatorëve, ndikim kishte edhe provizioni më i lartë për taksa se sa ai i vitit paraprak.

Figura 18. Treguesit e profitabilitetit të sektorit bankar



Shënim: Në kalkulim të KMA dhe KMK profiti për tremujorin përkatës është anualizuar.
Burimi: BQK (2018)


Treguesit e shëndetit financiar

Sektori bankar edhe gjatë tremujorit të dytë të vitit 2018 u karakterizua me rënie të nivelit të kredive joperformuese dhe përmirësim të mbulueshmërisë së tyre me provizione. Niveli i kredive joperformuese në fund të TM2 2018 qëndroi në 2.8 përqind, që paraqet një rënie prej 1.1 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak (figura 19).

Niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione u përmirësua edhe më tej duke qëndruar në 155.6 përqind, kryesisht si rrjedhojë e rënies së theksuar të vlerës së kredive joperformuese si dhe rritjes së provizioneve për humbje nga kreditë në periudhën raportuese.

Raporti i shpenzimeve ndaj të hyrave të sektorit shënoi rritje në TM2 2018 për 2.4 pikë përqindje,


Figura 19. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore dhe norma e rritjes së KJP-ve



Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur
Burimi: BQK (2018)

Niveli i kapitalizimit të sektorit bankar vazhdon të jetë dukshëm mbi nivelin minimal të kërkuar me rregullore prej 12.0 përqind. Treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ka qëndruar në nivel prej 17.4 përqind.

Figura 20. Treguesit e likuiditetit dhe të solvencës



Shënim: Të dhënat e paraqitura janë me gjendjen në fund të tremujorit të cekur
Burimi: BQK (2018)


Treguesi kyç i likuiditetit, raporti i mjeteve likuide ndaj gjithsej detyrimeve afatshkurtra, shënoi rënie në fund të TM2 2018 krahasuar me TM2 2017. Ky indikator qëndroi në nivel prej 33.2 përqind, një rënie për 2.7 pikë përqindje krahasuar me TM2 2017. Rënia e këtij treguesi i atribuohet rritjes së kredive, gjë që rezultoi në zvogëlim të aseteve likuide, si dhe

rritjes së detyrimeve afatshkurtra si rezultat i rritjes së depozitave të transferueshme (figura 20).

Sektori pensional

Sektori pensional gjatë TM2 2018 u karakterizua me rritje, si rezultat i kontributeve të reja të arkëtuara dhe performancës pozitive të mjeteve të investuara, kryesisht në tregjet e jashtme.

Figura 21. Asetet e sektorit pensional, ndryshimi tremujor




Burimi: BQK (2018)

Sektori pensional vazhdon të jetë sektori i dytë për nga pjesëmarrja në asetet e sistemit financiar me 28.3 përqind të gjithsej aseteve, ku stoku i aseteve të këtij sektori deri në qershor 2018 arriti vlerën prej 1.70 miliardë euro, rritje vjetore prej 10.2 përqind.

Gjatë TM2 2018, asetet e menaxhuara nga sektori pensional u rritën për 58.5 milionë euro, dukshëm më e lartë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar (figura 21). Kjo rritje e aseteve reflekton ecurinë e performancës së investimeve, që kryesisht janë të alokuara jashtë vendit, dhe përbëjnë pjesën më të madhe të aseteve të fondeve. Më konkretisht, FKPK që zotëron rreth 99.6 përqind të gjithsej aseteve të fondit pensional, në këtë tremujor rriti investimet në fondet e përbashkëta për 18.0 milionë

euro më shumë krahasuar me TM2 2018. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe edhe investimet në vend, përkatësisht në letrat me vlerë të Qeverisë së Kosovës u rritën për 29.8 milionë euro më shumë krahasuar me tremujorin e dytë të vitit të kaluar.

Figura 22. Struktura e aseteve të FKPK-së (TM2 2018)




Burimi: FKPK (2018)

Fondet pensionale që operojnë në Kosovë kanë strategji të ndryshme të investimit të aseteve të tyre. FKPK vazhdon të ndjekë një strategji të kujdesshme të investimit, duke siguruar diversifikim të rrezikut në fonde të përbashkëta investuese që menaxhohen nga ndërmarrjet për menaxhim të mjeteve. Në anën tjetër, FSKP investon asetet e tyre kryesisht në aksione jashtë vendit, pasuar nga asetet e investuara në obligacione si në Kosovë ashtu edhe jashtë vendit (figura 22 dhe 23).

Arkëtimet e reja gjatë tremujorit të dytë të vitit 2018 u shtuan për 3.5 milionë euro më shumë (8.7 përqind) krahas tremujorit të njëjtë të vitit paraprak dhe arritën në 43.1 milionë euro. Nga këto kontribute të arkëtuara, 99.4 përqind i takojnë FKPK-së dhe pjesa e mbetur FSKP-së.


Figura 23. Struktura e aseteve të FSKP-së (TM2 2018)



Burimi: FSKP (2018)

Në këtë tremujor FKPK kishte performancë pozitive nga investimet ku vlerësimi i aseteve të investuara u rrit duke rezultuar në një kthim bruto prej 19.4 milionë euro krahas kthimit bruto prej 9.5 milionë të tremujorit të dytë të vitit paraprak (figura 24). Ndërsa, FSKP pati një ngadalësim të kthimit bruto nga investimet duke zbritur në 54.1 mijë euro nga 227.8 mijë euro në TM2 2018.

Figura 24. Kthimi në investime dhe performanca e FKPK-së




Burimi: FKPK (2018)

Sektori i sigurimeve

Rritja e të hyrave nga primet dhe menaxhimi efikas i shpenzimeve operative ndikuan që sektori të kishte rezultat pozitiv financiar. Megjithatë, rritja e shpenzimeve për dëmet e paguara u pasqyrua në rritjen e kostos, gjë që ndikoi në nivelin e të hyrave neto që rezultuan të jenë dukshëm më të ulëta krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Figura 25. Asetet e sektorit të sigurimeve, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK (2018)

Edhe pse sektori i sigurimeve gjatë TM2 2018 u karakterizua me tkurrje të lehtë në asete, në përgjithësi ky sektor shënoi rezultate pozitive financiare dhe po vazhdon të zvogëlojë vlerën e humbjeve të akumuluar nga vitet paraprake.


Zvogëlimi i lehtë i aseteve të sektorit të sigurimeve në këtë tremujor u ndikua kryesisht nga rënia e investimeve në letrat me vlerë, përderisa sektori u karakterizua me rritje të nivelit të aseteve likuide. Në TM2 2018, asetet rezultuan me vlerë negative prej 0.7 milionë euro, që paraqet një rënie vjetore prej 5.6 milionë euro kundrejt TM2 2017 (figura 25).

Ecuria e gjithsej aseteve të sektorit reflekton zhvillimet në sektorin e sigurimeve 'jetë', asetet e të

cilave u zvogëluan për 1.9 milionë në TM2 2018. Kurse efekti i mëtejshëm negativ u neutralizua nga sektori 'jo-jetë', asetete e së cilës u rritën për 1.2 milionë euro gjatë këtij tremujori.

Vlera e primeve të shkruara nga kompanitë e sigurimeve gjatë TM2 2018 arriti vlerën prej 23.1 milionë euro, që paraqet një rritje vjetore prej 1.4 përqind. Primet e sigurimit jo-jetë përfaqësojnë 96.6 përqind të gjithsej strukturës së primeve të shkruara. Vlera e primeve të shkruara nga sigurimi jo-jetë arriti në 22.3 milionë euro në TM2 2018 (0.9 përqind rritje vjetore). Vlera e primeve të shkruara nga sigurimi 'jetë' u karakterizua me rritje vjetore prej 16.7 përqind duke arritur në 791.2 mijë euro.

Figura 26. Primet e shkruara dhe dëmet e paguara



Burimi: BQK (2018)

Dëmet e paguara nga sektori i sigurimeve dhe Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), u rritën në 11.3 milionë euro në TM2 2018 (10.4 milionë euro në TM2 2017), që paraqet një rritje prej 8.3 përqind. Pavarësisht që kemi rritje në arkëtimet prej primeve të shkruara, niveli më i lartë i dëmeve të paguara ndikoi në përkeqësimin e raportit dëme/prime, i cili në TM2 2018 u rrit në 49.0 përqind, nga 45.9 përqind sa ishte në tremujorin e dytë të vitit 2017 (figura 26).

Performanca e sektorit të sigurimeve

Sektori i sigurimeve në TM2 2018 shënoi performacë të mirë financiare, por më të ulët krahasuar me TM2 2017, si pasojë e rritjes së shpenzimeve për dëmet e paguara.

Të hyrat neto nga primet e sektorit të sigurimeve në TM2 2018 shënuan rritje vjetore prej 6.1 përqind, përderisa në të njëjtën periudhë, shpenzimet e sektorit të sigurimeve u karakterizuan me një rënie të lehtë prej 0.6 përqind krahasuar me TM2 2017. Përkundër rritjes së të hyrave kundrejt rënies së lehtë të shpenzimeve, rritja e dëmeve të ndodhura, prej 28.6 përqind, ndikoi që sektori i sigurimeve në TM2 2018 regjistrojë fitim prej 343.3 mijë euro, e që është fitim dukshëm më i ulët se ai i TM2 2017 prej 1.1 milionë euro.

Sa i përket pozitës së likuiditetit të sektorit, ky indikator shënoi përmirësim në TM2 2018, ku marrim për bazë stokun e aseteve deri në qershor 2018. Ky përmirësim u ndikua si nga rritja vjetore e stokut të parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj (0.3 përqind), ashtu edhe nga rënia e rezervave teknike (2.7 përqind), ku raporti në mes tyre arriti në 97.0 përqind nga 94.2 përqind në qershor 2017. Tregues tjerë të likuiditetit po ashtu u përmirësuan, mbështetur kryesisht nga rënia më e madhe e detyrimeve të sektorit, kundrejt rritjes së lehtë të stokut të parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj. Raporti ndërmjet parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj ndaj gjithsej detyrimeve në qershor 2018 qëndori në 86.5 përqind, nga 85.2 përqind sa ishte në qershor të vitit të kaluar.


Sektori mikrofinanciar

Rritja e konsiderueshme e aseteve të sektorit vazhdon të jetë e ndikuar kryesisht nga rritja e theksuar e stokut të kredive. Ngjashëm, sektori po karakterizohet me rritje të theksuar të hyrave dhe rrjedhimisht, performancë pozitive financiare.

Asetet

Sektori mikrofinanciar ishte sektori me rritjen më të lartë të stokut të aseteve në kuadër të sistemit financiar deri në qershor të vitit 2018. Edhe pse pesha e këtij sektori në gjithsej asetet e sistemit financiar është rritur, vazhdon të mbetet e ulët në rreth 3.7 përqind.

Figura 27. Asetet e sektorit mikrofinanciar, ndryshimi tremujor



Burimi: BQK (2018)

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2018, vlera e gjithsej aseteve të sektorit mikrofinanciar u rrit për 19.6 milionë euro (12.1 milionë euro në TM2 2017), duke arritur vlerën në 223.1 milionë euro në qershor 2018 (figura 27).


Zgjerimi i sektorit mikrofinanciar kryesisht i atribuohet rritjes së aktivitetit kreditues, që u

financua kryesisht nga huazimet në sektorin e jashtëm (68.4 përqind të gjithsej asetëve).

Kreditë

Gjatë TM2 2018, stoku i kredive u rrit për 13.0 milionë euro, e cila është për 2.9 milionë euro më shumë se sa rritja në TM2 2017 (figura 28). Kreditë për ekonomitë familjare, që kanë një pjesëmarrje prej 65.2 përqind në gjithsej kreditë e sektorit, gjatë TM2 2018 u rritën për 9.6 milionë euro, që është dukshëm më e lartë krahasuar me vlerën prej 6.1 milionë euro në TM2 2017. Në anën tjetër, kreditë ndaj ndërmarrjeve, që përfaqësojnë 34.8 përqind të gjithsej kredive të sektorit, u zvogëluan për 0.5 milionë euro krahasuar me TM2 2017, në 3.4 milionë euro. Pavarësisht dinamikave tremujore, stoku i kredive të lëshuara për ndërmarrjet dhe ekonomitë familjare shënuan rritje të theksuara vjetore.


Figura 28. Vlera e kredive ndaj ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve, rritja vjetore e kredive



Sa i përket kreditimit ndaj sektorëve ekonomik, sektorët më të rëndësishëm kreditues siç janë ai i bujqësisë, ndërtimtarisë, tregtisë dhe industrisë u karakterizuan me rritje gjatë këtij tremujori, për që

është më e ulët krahasuar me ecurinë në TM2 2017. Sektori që shënoi rritjen më të lartë vjetore në këtë tremujor ishte ai i bujqësisë prej 1.0 milionë euro, që njëkohësisht përfaqëson edhe kategorinë më të rëndësishme të kredive për ndërmarrje (27.3 përqind të gjithsej stokut të kredive) (figura 29).

Figura 29. Vlera e kredive ndaj ndërmarrjeve, sipas sektorëve ekonomik




Burimi: BQK (2018)

Lizingjet

Lizingjet gjatë tremujorit të dytë të vitit 2018 u rritën për 4.6 milionë euro, shifër dukshëm më e lartë krahasuar me rritjen prej 1.3 milionë euro në TM2 2017. (figura 30).

Në rritjen e vlerës së lizingjeve gjatë këtij tremujori kontribuoi rritja e “lizingjeve tjera” kryesisht për ndërmarrje, pa anashkaluar edhe rritjen e lizingut hipotekar për ekonomitë familjare.

Figura 30. Vlera e lizingjeve të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2018)

Normat e Interesit

Normat mesatare të interesit në kredi ndërruan kahje për dallim nga viti paraprak, duke shënuar rritje përgjithësisht në 22.9 përqind, nga 22.4 përqind sa ishte mesatarja për TM2 2017.

Figura 31. Norma mesatare e interesit në kredi të sektorit mikrofinanciar




Burimi: BQK (2018)

Norma e interesit për kreditë ndaj ekonomive familjare u rrit për 0.8 pikë përqind, ndërsa norma e interesit për kreditë ndaj ndërmarrjeve u karakterizua me rënie prej 0.1 pikë përqind (figura 31). Në kuadër të ekonomive familjare norma mesatare e interesit në kreditë konsumuese shënoi

rritje të theksuar për 14.8 pikë përqindje, në 39.0 përqind., ndërsa për kreditë hipotekare ajo u zvogëlua për 2.3 pikë përqindje, në 23.2 përqind.

Në kuadër të kredive ndaj ndërmarrjeve, sektori i shërbimeve vijon të ketë normën më të ulët të interesit në kredi. Ndërsa, sektori i industrisë vazhdon të ketë normën më të lartë të interesit në kredi duke shënuar rritje të mëtutjeshme për 0.1 pikë përqind (figura 32).

Figura 32. Norma mesatare e interesit në kredi për ndërmarrje, sipas sektorëve ekonomik



Burimi: BQK (2018)


Performanca e sektorit mikrofinanciar

Zhvillimet në aktivitetin kreditues dhe aktivitetin e lizingut në kuadër të sektorit, ndikuan që institucionet mikrofinanciare të kenë performancë të mirë financiare edhe gjatë TM2 2018. Profiti i sektorit arriti vlerë prej 2.8 milionë euro kundrejt TM2 2017 kur realizoi profit prej 2.1 milionë euro (figura 33).

Rritja e profitit kryesisht i atribuohet rritjes së theksuar të hyrave prej 2.6 milionë euro, vlera e të cilave arriti në 10.4 milionë euro në TM2 2018, më konkretisht rritjes të hyrave nga interesi prej 2.6

milionë euro, të cilat edhe përfaqësojnë rreth 88.6 përqind të gjithsej të hyrave.


Figura 33. Të hyrat dhe shpenzimet e sektorit mikrofinanciar



Burimi: BQK (2018)

Rritja e të hyrave nga interesi ishte rezultat i rritjes së aktivitetit kreditues nga institucionet mikrofinanciare në tre vitet e fundit, e po ashtu rezultat i rritjes së normës së interesit të aplikuar për kredi. Gjithsej shpenzimet e sektorit po ashtu shënuan rritje prej 1.9 milionë euro dhe arritën në 7.6 milionë euro në TM2 2018, prej të cilave rritjen më të madhe e patën shpenzimet nga jo-interesi, prej 1.3 milionë euro, rezultat i rritjes së shpenzimeve për provizionet për humbjet e mundshme në kredi si dhe shpenzimeve për personelin dhe atyre administrative.

Figura 34. Treguesit e profitabilitetit të sektorit mikrofinanciar




*Profiti është anualizuar për tremujorin përkatës
Burimi: BQK (2018)

Si rezultat i performancës pozitive financiare gjatë tremujorit të parë, treguesit e profitabilitetit të kalkuluar për gjithë vitin shënuan përmirësim (figura 34).

Institucionet mikrofinanciare vazhdojnë të karakterizohen me nivel të ulët të kredive me probleme dhe mbulueshmëri të mirë me provizione.

Figura 35. Treguesit e kualitetit të portofolios kreditore




Burimi: BQK (2018)

Niveli i kredive joperformuese në raport me gjithsej kreditë deri në qershor 2018 mbeti i pandryshuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak, në 2.5 përqind (figura 35). Kurse, niveli i mbulueshmërisë së kredive joperformuese me provizione në qershor 2018 arriti në 210.2 përqind krahasuar me nivelin prej 202.6 përqind në qershor 2017.

Tregu i letrave me vlerë

Në TM2 2018, Departamenti i Thesarit i Ministrisë së Financave të Qeverisë së Kosovës realizoi 6 ankande, në të cilat u emetuan bono dhe fletë-obligacione qeveritare në vlerë prej 114.4 milionë euro (figura 36).

Figura 36. Shuma e borxhit të emetuar, rritja vjetore



Burimi: Ministria e Financave

Vlera e emetuar e letrave me vlerë në këtë tremujor ishte për 18.3 përqind më e ulët se në tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar, kurse për 5.6 përqind më e lartë se në tremujorin paraprak. Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kemi zvogëlim të vlerës së emetuar si të bonove të thesarit dhe të fletë-obligacioneve qeveritare (tabela 1).

Tabela 1. Numri dhe shuma e letrave me vlerë të arkëtuara nga Qeveria e Kosovës


Periodha	Bonot e thesarit		Fletë-obligacionet	
	Numri i realizuar	Vlera e pranuar	Numri i realizuar	Vlera e pranuar
TM2 2015	4	80.00	2	29.95
TM2 2016	4	100.00	1	30.00
TM2 2017	2	50.00	4	90.00
TM2 2018	2	39.57	4	74.85

Burimi: Ministria e Financave (2018)

Norma mesatare e interesit në letrat me vlerë në TM2 2018 ka shënuar rritje (1.33 përqind) krahasuar me TM2 2017 (0.44 përqind). Kjo rritje mund të jetë ndikuar nga emetimi i fletë-obligacioneve me maturitet më të gjatë krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak. Po ashtu, rritja e normës mestarë të interesit mund të jetë ndikuar edhe nga oferta/kërkesa në letrat me vlerë (figura 37). Shuma e kërkuar nga pjesëmarrësit ishte për 1.2 herë më e

lartë se shuma e emetuar në ankande nga Ministria e Financave (1.4 herë më e lartë në TM2 2017).


Figura 37. Shuma e kërkuar dhe emetuar



Burimi: Ministria e Financave (2018)

Struktura e letrave me vlerë sipas afatit të maturimit në këtë tremujor dominohet nga bonot e thesarit me afat maturimi 182 ditë dhe fletë-obligacionet qeveritare me afat maturimi 3 vite me pjesëmarrje prej 21.8 përqind në gjithsej letrat me vlerë të emtuara secila nga kategoritë.

Figura 38. Struktura e letrave me vlerë të Qeverisë, në përqindje



Burimi: Ministria e Financave (2018)

Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, nuk kemi të emetuara bono me afat maturimi deri në 91 ditë, kurse kemi tendencë të emetimit të fletë-obligacioneve qeveritare me afat më të gjatë të maturimit (mbi 5 vite, përkatësisht mbi 7 vite) (figura 38).

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK (2018): Vlerësimi Tremujor i Sistemit Financiar Nr. 23, TM2 2018, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

Referencat:

BQK (2018):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>

ASK (2018):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-
- c) Indeksi i çmimeve të importit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>
- f) Buletini Tremujor

Të tjera (2018):

- a) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandevë për letra me vlerë të qeverisë: <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,46>
- b) Fondi Kosovar për Garanci Kreditore: <http://www.fondikgk.org/>
- c) Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës; Raporte tremujore: <http://www.trusti.org/sq/per-ne/raporte/835-2/>

Bloomberg (2018): Metal Prices database.

FAOUN (2018): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2018): Euribor Historical Rates:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2018): World Economic Outlook:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2016/02/weodata/index.aspx>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	TM2 2017	TM2 2018
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)	1,605.1	-
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	1.9%	0.7%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	1.9%	0.8%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	414.6	439.2
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	417.7	427.7
Bilanci primar (në milionë euro)	-3.1	11.5
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	5,566.3	6,002.6
prej të cilave: Bankat	3,671.2	3,891.5
Kredi	2,390.5	2,661.3
Depozita	2,887.8	3,085.9
Norma e interesit në kredi, fundi i periudhës	6.8%	6.5%
Norma e interesit në depozita, fundi i periudhës	1.1%	1.2%
Hendeku i normës së interesit	5.7%	5.3%
Sektori i jashtëm*, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-198.2	-205.1
prej të cilave: remitencat e pranuar	125.5	137.4
Llogaria financiare	-80.9	-107.8
Investimet e huaj direkte në Kosovë	50.0	45.5
Investimet portfolio, net	13.2	1.3
Investimet tjera, net	-35.2	-101.7
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net	-89.6	-111.0
Asetet	4,650.0	4,776.0
Detyrimet	4,739.5	4,887.0
Borxhi i jashtëm, gjithsej	2,075.4	1,998.3
Borxhi i jashtëm privat	1,570.5	1,598.3
Borxhi i jashtëm publik	1541.8	1511.6

Burimi:

1/ ASK (2017).

2/ MF (2017).

3/ BQK (2017).

*Të dhënat për bilancin e pagesave përfshijnë muajt prill dhe maj ndërsa për PNI dhe borxh të jashtëm TM1

